

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 23.01.2023*

23.01.2023  
Ora 12:44

**RENDI I DITËS**

“Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesës ankimore nr. 12, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25, 26 dhe 27”.

**PJESËMARRJA :**

- **Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirja RUSMALI,**  
**Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.**
- **Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Z. Erdal Mema, Znj. Kejsa Bici.**
- **Të tjerë: Z. Mustafa Gjinaj, Z. Aristotel Petro, Z. Sidi Hodo**  
**KRIIK**

**Z. L. Braho:** Përshëndetje! Riçelim seancën për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore numër 12, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25, 26, dhe 27 të depozituara në KQZ në muajt dhjetor 2022 dhe janar 2023, që kanë për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimet e fondeve publike të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 25.04.2021. Në lidhje me këtë vendimmarrje ka pasur një sërë ankimesh nga disa subjekte OSHMA të cilat kanë ngritur pretendime në lidhje me dënimet administrative që janë vendosur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Si fillim përpara se të shpallim vendimin, është për tu sqaruar se vendimmarrja është ndarë në dy pjesë.

Një pjesë i takon arsyetimit vetëm për ato OSHMA të cilat janë gjobitur për shkak të mosdorëzimit të tarifave zyrtare në KQZ sipas afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor që ishte 5 ditë para nisjes së fushatës zgjedhore.

**Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 23.01.2023*

Pjesa tjetër ka të bëj me dy OSHMA që janë gjobitur për shkak të tejkalimit të minutazhit prej 90 minutash që mund të transmetojnë reklama politike.

Si fillim është për tu sqaruar statusi i ndryshëm mes radiotelevizionit publik dhe OSHMA-ve private. Vet ligjvënësi i Kodit Zgjedhor ka parashikuar rregullim të ndryshëm mes këtyre dy subjekteve për shkak të statusit të ndryshëm. Kodi Zgjedhor bën diferencim mes tyre ku përcakton se në radiotelevizionin publik reklammat transmetohen pa pagesë ndërkohë që në radio dhe televizionet private zbatohen tarifa të njëjta brënda të njëjtit segment kohor përgjatë kohës së fushatës. Në kuptim të kësaj dispozite një OSHMA private i përcakton vetëm maksimumi i minutazhit që mund të transmetojë reklama politike, ç'ka e lë në zgjedhje të OSHMA-ve private edhe të mos të transmetojë edhe asnjë reklamë politike gjatë fushatës zgjedhore. Në lidhje me faktin që OSHMA-të private zgjedhin apo jo të transmetojnë reklama politike, një zgjedhje e tillë përcaktohet në nenin 11 të Kushtetutës që parashikon parimin themelor se sistemi ekonomik në Shqipëri bazohet në veprimtarinë e lirë ekonomike. Sipas pikës 3 të këtij neni kufizime të veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike. Sa i përket rastit objekt shqyrtimi ligjvënësi ka konsideruar si kufizim vetëm minutazhin maksimal që është ai prej 90 minutash si dhe tarifatat që duhet të përcaktohen nëqoftëse do të transmetohen reklama politike që për segmente të njëjta kohore duhet të jenë të njëjta panvarësisht subjekteve politike që përzgjedhin të reklamojnë reklamat e tyre politike.

Elementi i parë që vlen për tu sqaruar ka të bëjë në lidhje me mungesën e vullnetit të këtyre OSHMA-ve për të transmetuar reklama politike gjatë fushatës zgjedhore dhe për rrjedhojë edhe mosdorëzimi i tarifave për segmentet kohore gjatë fushatës. Së pari historiku i sjelljes ose i veprimeve apo mosveprimeve që KQZ ka pasur në lidhje me këtë dispozitë. Dispozita që parashikon këtë detyrim është një dispozitë

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 23.01.2023*

që ka formulimin siç e ka sot që nga viti 2012 dhe janë zhvilluar më shumë se katër herë zgjedhje që nga ndryshimi dhe në historikun e KQZ-së nuk rezulton që të ketë asnjë subjekt, asnjë OSHMA që të jetë dënuar administrativisht në lidhje me mosdorëzimin e tarifave. Megjithatë këtu vlen për tu theksuar se ky nuk është argument për të mos qëndruar vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve por me ndryshimet që ka pësuar Kodi Zgjedhor në vitin 2020 ku KQZ-ja si institucion është riformatuar nga një organ kolegjal në tri organe drejtuese ku një prej tyre është edhe Komisioni Rregullator. Një pjesë e kompetencave për hatimin e projektakteve i ka kaluar Komisionit Rregullator ku dhe një nga kompetencat ishte dhe miratimi i rregullave për metodologjinë e monitorimit medias për procedurën e shqyrtimit të raporteve dhe për vendosjen e masave qortuese apo ndëshkimore. Pikërisht këtu në këtë kompetencë, në këtë akt normativ Komisioni Rregullator duhet të përcaktonte dhe mënyrën se si OSHMA-të do të mund të shprehnin vullnetin nëqoftëse nuk do e kishin vullnetin për të transmetuar reklama politike. Mungesa e rregullimit të shprehjes së këtij vullneti nga komisioni rregullator e bën që OSHMA-të mos të kenë pasur një bazë ligjore që të shprehnin vullnetin për mostransmetim të reklamave politike. Fakti që ky element nuk është sqaruar në aktin e Komisionit Rregullator i bën OSHMA-të që të jenë pa faj përsa i përket kësaj pjese. Për atë kohë sa Kodi Zgjedhor e përcakton si një të drejtë të tyre dhe jo detyrim transmetimin e reklamave politike, ka një vakum ligjor përsa i përket mënyrës së shprehjes së vullnetit nga ana e tyre kundrejt KQZ-së për mostransmetimin e reklamave politike. Po ashtu nga vetmonitorimi që Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve ka kryer nuk rezulton që ndonjë prej OSHMA-ve që kanë depozituar kërkesat ankimore të kenë transmetuar reklama politike gjatë periudhës së zgjedhjeve të 25 Prillit 2021. Atëherë akti administrativ, objekt shqyrtimi administrativ për këto subjekte është i paligjshëm.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 23.01.2023*

Në lidhje me dy OSHMA-të e tjera që kanë tejkaluar minutazhin. E para tejkalimi i minutazhit prej 90 minuta për njërën është 6.97 minuta ndërsa për tjetrën është 1.6 minuta për KAS-in krijohet bindja se vullneti i këtyre OSHMA-ve panvarësisht tejkalimit ka qënë i tillë për të respektuar ligjin dhe një tejkalim i tillë do të jetë si pasojë edhe e gabimit njerëzorë. Ndaj, duke qënë se po ashtu dhe vendimet administrative që janë vendosur edhe ndaj OSHMA-ve të tjera që kanë tejkaluar edhe me qindra minuta minutazhin është i njëjtë për KAS-in kjo mënyrë me të cilën është aplikuar dënimi administrativ bie ndesh me parimin e propocionalitetit. Edhe përse i përket këtij akti administrativ me këto dy OSHMA ai konsiderohet i paligjshëm pikërisht sepse bie ndesh me parimin e propocionalitetit.

Në lidhje me kërkesën ankimore të subjektit A2CNN panvarësisht se edhe në kërkesë ankimore dhe nga përfaqësuesi i këtij subjekti u pretendua vetëm rishikimi i masës së dënimit administrativ në përputhje me shkeljen që ata kishin bërë për KAS në zbatim të nenit 143 pika, 2 të Kodit Zgjedhor që parashikon se KQZ merr vendim sipas njërit nga rastet të parashikuar në pikën 1 të këtij neni panvarësisht çfarë ankuesi ka kërkuar në ankimin e tij e konsideron këtë akt të paligjshëm në tërësinë e tij.

Për këto arsye mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja b dhe 143 shkronja c të Kodit Zgjedhor KAS vendosi:

- Pranimin e kërkesave ankimore 12, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 25, 26, dhe 27 të paraqitura nga OSHMA-të TV Mati, Club TV, A2CNN (G2 Media), TV Klaudiana, Radio Saranda Televizion, TV Berati, Glob TV, TV Alpo (AMG 2000), TV Apollon, TV Kopliku, TV Best Channel, TV-Era-Digitalb dhe Televizioni Kukës.

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt 23.01.2023*

- Shfuqizimin e vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për dënimet administrative me gjobë të vendosura ndaj këtyre OSHMA-ve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

**Vendim nr. 5**

*Zbardhi materialin audio  
Jona DERVISHI*

